

VENDIM
Nr.45, datë 28.7.2010

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
PRIVAT VENDOR “RADIO X”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti radiofonik privat vendor “Radio X”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21 dhe neni 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, vendimi nr.845, datë 24.4.2009 i KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VËREN SE:

Në bazë të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, shoqëria “X” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin për rinovim licence për radion private vendore “Radio X”.

Me vendimin nr.845, datë 24.4.2009, KKRT ka vendosur paraprakisht mosrinovimin e licencës për subjektin “Radio X”, si rrjedhojë e mosparaqitjes së kontratave të punës dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për personat e punësuar dhe objektit jo ekskluziv të veprimtarisë.

Megjithatë, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbledhjen e tij të radhës të datës 22.12.2009, pasi mori në shqyrtim aplikimet për rinovim licence të disa subjekteve, mes të cilave edhe “Radio X”, vendosi që të gjitha subjektet të njoftohen për të plotësuar një sërë mangësish të konstatuara, duke u lënë në dispozicion një afat të caktuar.

Në bazë të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, rregullores “Mbi rilicencimin e operatorëve radio e televizivë” dhe urdhrin nr.35 të kryetarit të KKRT-së, më datë 22.2.2010, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit u mblodh për të shqyrtuar plotësimet e depozituara në KKRT nga subjektet.

Nga verifikimi përkatës, rezulton se subjekti “Radio X” nuk ka depozituar plotësimet e kërkuara për rinovimin e licencës. Konkretisht, ekstrakti i QKR-së mungon; plani ekonomik-financiar i pafirmosur dhe i pavulosur; të dhënat mbi kapitalin financiar janë depozituar të fotokopjuara; nuk identifikohet inxhinieri i projektit teknik; të dhënat mbi programet janë të pafirmosura dhe të pavulosura; CV-të e anëtarëve të Bordit Drejtues janë të pafirmosura prej tyre; nuk janë paraqitur kontratat e punës dhe vërtetimi për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për personat e punësuar. Gjithashtu, subjekti nuk ka depozituar në KKRT asnjë bilanc financiar për kohën e vlefshmërisë së licencës.

Për sa më sipër, subjektit “Radio X” nuk mund t’i jepet akoma mundësia për të

depozituar plotësimet përkatëse për mangësitë e konstatuara.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe 33 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.066/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio X”.
 2. Licenca me nr.066/FML bëhet e pavlefshme.
 3. Subjekti, sipas pikës 1, të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati